11. Ngarkohet Komisioni i Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 88/2025, "Për koncensionet dhe partneritetin publik privat".

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 679, datë 11.9.2026

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE PËR KOMUNIKIMIN ME MJETE ELEKTRONIKE NË PROCEDURAT KONKURRUESE TË KONCESIONIT/ PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 88/2025, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

1. VENDOSI:

1. Publikimi i dokumenteve të procedurave konkurruese të koncesionit dhe dorëzimi i ofertave të operatorëve për këto procedura do të zhvillohen me mjete elektronike.

2. Përjashtimisht nga pika 1, e këtij vendimi, në procedurat konkurruese të koncesionit me faza, komunikimet dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet autoritetit ose entit kontraktues dhe operatorëve ekonomikë, në fazat që vijojnë pas dorëzimit të ofertave, zhvillohen në formë shkresore, në përputhje me mjetet e komunikimit, të parashikuara në pikën 1, të nenit 32, të ligjit nr. 88/2025.

3. Për procedurat e dhënies së kontratave të partneritetit publik privat, për sa i takon komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit, zbatohen rregullat e legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr. 88/2025.

4. Vendimi nr. 130, datë 12.3.2014, i Këshillit të Ministrave, "Për kryerjen në mënyrë elektronike të procedurave konkurruese të koncesionit dhe partneritetit publik privat", shfuqizohet.

5. Ngarkohen të gjitha autoritetet dhe entet kontraktore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 88/2025, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat".

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 681, datë 11.9.2026

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSIONI I KANALIT TË UJËRAVE TË LARTA, LOTI 1", BASHKIA VLORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksioni i kanalit të ujërave të larta, loti 1", Bashkia Vlorë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "truall", përfshirë dhe sipërfaqe "ndërtesë", me një vlerë të përgjithshme prej 11 105 855 (njëmbëdhjetë milionë e njëqind e pesë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 11 105 855 (njëmbëdhjetë milionë e njëqind e pesë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë) lekësh përballohet nga buxheti i Bashkisë Vlorë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Vlorë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Vlorë.

8. Bashkia Vlorë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Vlorë.

10. Bashkia Vlorë, pas miratimit të këtij vendimi, aplikon menjëherë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, e cila, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të vendimit, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Vlorë për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Vlorë për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSION I KANALIT TË UJËRAVE TË LARTA, LOTI I" , BASHKIA VLORË

Pronari		Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)								Vlerësimet për shpronësim								
										Truall			Ndërtesë					
Nr.	Emër/Mbiemër	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m²)	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Volum	Faqe	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lekë)	Vlera totale (lekë)	Shënime	
1	Haxhi Korkaj	8605	42/129	Truall	301.2	301.2	81.7	32	243	81.7	8300	678,110	81.7	124,150.00	10,143,055	10,821,165		
2	Shkelqim Sabaudin Musaraj	8605	42/181	Truall	281	281	125	50	81	5.3	8300	43,990				43,990		
3	Jani Qirko	8605	37/209	Truall	339	339	111	59	199	29	8300	240,700				240,700		
	VLERA TOTALE															11,105,855		

VENDIM
Nr. 682, datë 11.9.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 480, DATË 26.6.2026, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKITË KRUJË E KURBIN, DHE CAKTIMIN E BASHKIVE KRUJË E KURBIN SI NJËSI ZBATUESE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nënndarjeve "i" e "iii", të shkronjës "b", të nenit 13, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, dhe të ligjit nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 480, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Krujë e Kurbin, dhe caktimin e bashkive Krujë e Kurbin si njësi zbatuese", bëhen këto ndryshime:

a) Në paragrafin e parë, vlera "... 300 618 237, 34 (treqind milionë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e shtatë presje tridhjetë e katër) lekë ..." zëvendësohet me "... 267 872 232, 84 (dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e dyqind e tridhjetë e dy presje tetëdhjetë e katër) lekë ...";

b) Në shkronjën "a", vlera "... 196 476 027 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëzet e shtatë) lekë ..." zëvendësohet me "... 163 730 022,50 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre milionë e shtatëqind e tridhjetë mijë e njëzet e dy presje pesëdhjetë) lekë ...".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 683, datë 11.9.2026

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I UJËSJELLËSIT ÇUKË–BËRBËNESH", BASHKIA SARANDË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Ndërtimi i Ujësjellësit Çukë–Bërbënesh", Bashkia Sarandë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve.

3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit "kullotë", me një vlerë të përgjithshme prej 283 200 (dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 283 200 (dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind) lekësh, përballohet nga buxheti i Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve.

8. Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Në momentin e ekzekutimit të procedurave për likuidim, për pasurinë, pronë private, që shpronësohet me anë të këtij vendimi, masa e shpërblimit do të vendoset në një llogari të posaçme bankare dhe do t'i vendoset në dispozicion personit që rezulton nga vendimi i formës së prerë të gjykatës, në përputhje me pikën 2, të nenit 16, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar.

10. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Sarandë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasurinë që shpronësohet, sipas këtij vendimi, në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve.

12. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasurinë që shpronësohet, sipas këtij vendimi, në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së

Infrastrukturës dhe Energjisë për Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve.

13. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Sarandë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILËT SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "NDËRTIMI I UJËSJELLËSIT ÇUKË–BËRBËNESH", BASHKIA SARANDË

Nr.	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)					Vlerësimet për shpronësim, sipas llojit të pasurisë					Shënime (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
									"Kullotë"					
	Emri	Atësia	Mbiemri	Qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m²)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/ m²)	Vlera (lekë)	Vlera totale		
1	Refije Artan Alban Elvin	Hamdi Faik Faik Faik	Islamaj Islamaj Islamaj Islamaj	Ksamil	2297	1/785	Kullotë	144,750	1,600	177	283,200	**283,200**		Seksioni D: *1. Në bazë të vendimit nr. 23-2015-749, datë 14.4.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, është vendosur marrja e masës së përkohshme të sigurimit të padisë dhe vendosje e sekuestros konservative mbi këtë pronë. Sigurim padie*
Vlera totale												**283,200**		

VENDIM
Nr. 684, datë 11.9.2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 833, DATË 20.11.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT 'RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS SHKODËR–VELIPOJË (SEGMENTI HARKU I BËRDICËS–BAKS)', SHKODËR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 833, datë 20.11.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Rikonstruksioni i rrugës Shkodër–Velipojë (segmenti Harku i Bërdicës–Baks)', Shkodër", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 3, vlera "...18 852 893 (tetëmbëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë ..." zëvendësohet me vlerën "... 19 580 624 (nëntëmbëdhjetë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e mijë e gjashtëqind e njëzet e katër) lekë ...";

b) Tabelës bashkëlidhur vendimit i shtohet tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vlera prej 727 731 (shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë e një) lekësh përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria "Fondi i shpronësimeve", në Bankën e Shqipërisë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

4. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Bashkia Shkodër.

6. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Bashkia Shkodër, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, si dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS SHKODËR–VELIPOJË (SEGMENTI HARKU I BËRDICËS–BAKS)", SHKODËR

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja totale (m²)	Lloji i pasurisë	Tokë "arë"			Tokë "truall"			Vlera e kulturave bujqësore dhe drufrutore (lekë)	Vlera totale (lekë)	Shënime (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
								Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)			
67	Nuh	Jaho	Velija	1159	8/48	176	Arë	176	270	47520					47520	
68	Nuh	Jaho	Velija	1159	8/49	1564	Arë	16.5	270	4455					4455	
69	Hajri Bilal Ilir Jup		Velija	1159	8/61	500	Arë	406	270	109620					109620	
70	Jup		Velija	1159	8/60	1322	Arë	334.6	270	90342					90342	
71	Ilir		Velija	1159	8/59	1322	Arë	300.2	270	81054					81054	
72	Bilal		Velija	1159	8/58	1322	Arë	267.7	270	72279					72279	
73	Hajri		Velija	1159	8/57	1322	Arë	210	270	56700					56700	
74	Ruzhdi	Selim	Meti	1159	11/51	1175	Arë	123.4	270	33318					33318	
75	Ruzhdi		Meti	1159	866/8	1062	Arë	339.4	270	91638					91638	
76	Sabri	Ymer	Rrustemi	1158	476/13	2385	Arë	521.5	270	140805					140805	
Vlera totale e shpronësimit															**727731**	

VENDIM
Nr. 685, datë 11.9.2026

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 38, DATË 21.1.2026, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË NË TND EDHE PËR KANDIDATË TË TJERË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL DHE PËR PËRDORIMIN E PROCEDURËS SË PRANIMIT TË DREJTPËRDREJTË NË TND, PËR VITIN 2026"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 27, pika 5, e 29, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, si dhe në vijim të pikave 2, 3 e 4, të kreut V, të vendimit nr. 118, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e emërimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3, të vendimit nr. 38, datë 21.1.2026, të Këshillit të Ministrave, "Për hapjen e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil dhe për përdorimin e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND, për vitin 2026", togfjalëshi "... është 11 (njëmbëdhjetë) ..." zëvendësohet me "... është 15 (pesëmbëdhjetë) ...".

2. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 686, datë 11.9.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 39, DATË 21.1.2026, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT, PËR VITIN 2026, NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE, PJESË TË SHËRBIMIT CIVIL"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 39, datë 21.1.2026, të Këshillit të Ministrave, "Për planin vjetor të pranimit, për vitin 2026, në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil", bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në paragrafin e parë, togfjalëshi "... gjithsej, 1067 (një mijë e gjashtëdhjetë e shtatë) ..." zëvendësohet me "... gjithsej, 1071 (një mijë e shtatëdhjetë e një) ...";

b) Në shkronjën "a", shifra 11 bëhet 15.

2. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR
Nr. 906, datë 3.9.2026

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE MBI KËRKESAT SPECIFIKE TË TRAJNIMIT PËR STAFIN, PËR KRYERJEN E KONTROLLEVE FIZIKE TË CAKTUARA NË PIKAT E KONTROLLIT KUFITAR[2]

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të nenit 104, pika 6, të ligjit nr. 61, datë 30.6.2026, "Për kontrollet zyrtare dhe aktivitete të tjera zyrtare të kryera për të garantuar zbatimin e legjislacionit për ushqimin dhe ushqimin për kafshë, të rregullimeve për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, si dhe për shëndetin e bimëve e të produkteve për mbrojtjen e bimëve në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

Neni 1
Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Ky urdhër përcakton rregullat për caktimin e kërkesave specifike për trajnim, siç përcaktohet në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 2, të nenit 49, të ligjit nr. 61, datë 30.6.2026, "Për kontrollet zyrtare dhe aktivitete të tjera zyrtare të kryera për të garantuar zbatimin e legjislacionit për ushqimin dhe ushqimin për kafshë, të rregullimeve për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, si dhe për shëndetin e bimëve e të produkteve për mbrojtjen e bimëve në Republikën e Shqipërisë", këtu e në vijim ligji për kontrollet zyrtare, për stafin, i cili kryen kontrolle fizike në Pikat e Kontrollit Kufitar (PKK), dhe që:

a) asiston një veteriner zyrtar në kryerjen e kontrolleve fizike në kafshët e gjalla, përveç kafshëve ujore ose në mish dhe të brendshmet e ngrënshme të mishit;

b) kryen kontrolle fizike në kafshët ujore, në produktet me origjinë shtazore, përveç atyre të parashikuara në shkronjën "a" të kësaj pike, në produktet germinale ose në nënproduktet shtazore që nuk janë të destinuara për konsum njerëzor.

[2] Ky urdhër është përafruar plotësisht me Rregulloren e Deleguar të Komisionit (BE) 2019/1081, të datës 8 mars 2019, që përcakton rregullat mbi kërkesat specifike të trajnimit për stafin, për kryerjen e kontrolleve fizike të caktuara në Pikat e Kontrollit Kufitar.

2. Ky urdhër nuk zbatohet për veterinerët zyrtarë dhe për inspektorët zyrtarë të shëndetit të bimëve.

Neni 2
Detyrimet e përgjithshme të autoritetit kompetent në lidhje me trajnimin

1. Stafi i përcaktuar shkronjat "a" dhe "b", të pikës 1, të nenit 1 të këtij urdhri asiston veterinerin zyrtar në kryerjen e kontrolleve fizike ose kryejnë kontrolle fizike, në përputhje me pikën 2, të nenit 49, të ligjit për kontrollet zyrtare, vetëm pasi të kenë përfunduar me sukses një program trajnimi që plotëson kërkesat e nenit 3 të këtij urdhri.

2. Institucioni përgjegjës për kryerjen e kontrollit zyrtar në PKK, që është autoriteti kompetent i kontrollit në PKK, këtu e në vijim autoriteti kompetent, zhvillon dhe organizon programin e trajnimit për të siguruar që kontrollet fizike të parashikuara në nenin 1 të këtij urdhri të kryhen me nivelin e nevojshëm të kompetencës teknike dhe ekspertizës. Programi i trajnimit është teorik dhe praktik.

3. Autoriteti kompetent mban regjistra të programit të trajnimit në formë të shkruar ose elektronike për çdo individ, duke përfshirë datat, kohëzgjatjen, përshkrimin e programit, dhe kur është e nevojshme, certifikatat që vërtetojnë përfundimin me sukses të programit të trajnimit nga stafi. Autoriteti kompetent siguron që çdo pikë kontrolli kufitare brenda vendit, të ketë akses në regjistrat e trajnimit që mbahen në formë të shkruar ose elektronike.

Neni 3
Kërkesat lidhur me përmbajtjen e programit të trajnimit

1. Përmbajtja e programit të trajnimit përcaktohet në përputhje me kafshët dhe mallrat për të cilat janë autorizuar Pikat e Kontrollit Kufitar, si dhe me detyrat dhe përgjegjësitë që i janë ngarkuar stafit.

2. Programi i trajnimit përfshin temat e mëposhtme:

a) legjislacionin në fuqi në lidhje me hyrjen në Republikën e Shqipërisë të kafshëve dhe mallrave, përfshirë procedurat dhe veprimtaritë që duhet të kryhen gjatë dhe pas kontrolleve fizike;

b) parimet e përgjithshme të kontrollit të kafshëve;

c) vlerësimin e aftësisë së kafshëve për udhëtim;

ç) aspektet praktike të trajtimit të kafshëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi, përfshirë masat për parandalimin ose reduktimin e vonesave në Pikat e Kontrollit Kufitar, dhe kur është e nevojshme, ushqyerjen, furnizimin me ujë, shkarkimin dhe akomodimin e kafshëve;

d) kontrollin shqisor të mallrave;

dh) kontrollin e mjeteve të transportit dhe kushteve të transportit, përfshirë menaxhimin e mallrave të ndjeshme ndaj temperaturës (zinxhiri ftohtës) dhe transportin e kafshëve;

e) identifikimin e specieve të kafshëve, përfshirë, sipas rastit, identifikimin e specieve aliene invazive, të cilat janë specie të huaja dhe për të cilat është konstatuar se futja ose përhapja e tyre kërcënon ose ndikon negativisht mbi biodiversitetin dhe shërbimet ekosistemetike të lidhura, të futura përmes kafshëve dhe mallrave;

ë) procedurat e kontrollit, të lidhura me:

i. përdorimin e pajisjeve;

ii. zbatimin e planeve të monitorimit;

iii. procedurat e marrjes së mostrave dhe analizat laboratorike në lidhje me kafshët dhe aspektet e shëndetit të kafshëve dhe të shëndetit publik;

f) metodat për interpretimin e rezultateve të testeve laboratorike dhe vendimmarrjen përkatëse, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;

g) vlerësimin e riskut, përfshirë mbledhjen e të dhënave, në lidhje me shëndetin e kafshëve dhe shëndetin publik, me qëllim kryerjen e kontrolleve fizike të orientuara në mënyrë të përshtatshme;

gj) parandalimin e kontaminimit të kryqëzuar dhe përputhshmërinë me standardet përkatëse të biosigurisë;

h) kërkesat e etiketimit për mallrat e parashikuara në shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 47 të ligjit për kontrollet zyrtare;

i) metodat hetimore dhe teknikat e kontrollit për zbulimin e praktikave mashtruese ose të padrejta në tregti.

Neni 4
Aktivitetet dhe programet e trajnimit për shkëmbimin e stafit, të organizuara në përputhje me nenin 103 të ligjit për kontrollet zyrtare

Me përjashtim të pikës 1, të nenit 2 të këtij urdhri, stafi i përcaktuar në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 1, të nenit 1, mund të asistojë veterinerin zyrtar në kryerjen e kontrolleve fizike ose të kryejë kontrolle fizike në përputhje me pikën 2, të nenit 49 të ligjit për kontrollet zyrtare, nëse është trajnuar në kuadër të veprimtarive të trajnimit ose programeve për shkëmbimin e stafit, të organizuara në përputhje me nenin 103 të ligjit për kontrollet zyrtare, me kusht që këto veprimtari ose programe të përfshijnë përmbajtjen dhe temat e programit të trajnimit të përmendur në pikën 2, të nenit 3 të këtij urdhri.

Neni 5
Dispozita të fundit

1. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe institucioni përgjegjës për kryerjen e kontrollit zyrtar në Pikat e Kontrollit Kufitar për zbatimin e këtij urdhri.

2. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 gusht 2027.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 912, datë 8.9.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË SHFAQUR NË SHTETIN E FRANCËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Francës, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	**Ndarja administrative e nivelit të dytë**	**Ndarja administrative e nivelit të tretë**
Ariège*		
Aude*		
Aveyron*		
Cantal*		
Creuse*		
Dordogne*		
Gers*		
Haute-Garonne*		
Hautes-Pyrénées*		
Haute-Savoie*		
Hérault*		
Landes*		
Lot*		
Manche*		
Puy-de-Dôme*		
Pyrénées-Atlantiques*		
Savoie*		
Tarn*		
Isère*		
Lozère*		

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe

Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 894, datë 3.9.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Francës", shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 913, datë 8.9.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE DHIVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E RUMANISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës së kafshëve të llojit dhen dhe dhi përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e pikës 2.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e lisë së dhenve dhe dhive, të shfaqur në shtetin e Rumanisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2*
1.	Mureş	Voivodeni*
2.	Mureş	Vatava*
3.	Mureş	Zau De Campie*
4.	Mureş	Suseni*
5.	Buzău	Padina*
6.	Iaşi	Popesti*
7.	Tulcea	Murighiol*
8.	Vâlcea	Malaia*
9.	Gorj	Turcinesti*
10.	Constanţa	Istria*
11.	Gorj	Targu Jiu*
12.	Constanţa	Vulturu*
13.	Tulcea	Peceneaga*
14.	Brăila	Maxineni*
15.	Tulcea	Valea Nucarilor*
16.	Tulcea	Ostrov*
17.	Galaţi	Tudor Vladimirescu*
18.	Brăila	Gemenele*
19.	Buzău	Luciu*
20.	Gorj	Bengesti*
21.	**Brăila**	**Tufesti***
22.	**Tulcea**	**Mihail Kogalniceanu***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës së kafshëve të llojit dhen dhe dhi.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës së kafshëve të llojit dhen dhe dhi, për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Urdhri nr. 908, datë 4.9.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive, të shfaqur në shtetin e Rumanisë", shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 916, datë 9.9.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË SHFAQUR NË SHTETIN E AUSTRISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Austrisë, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Niederösterreich	Baden	Altenmarkt an der Triesting*
Vorarlberg	Bregenz	Lauterach*
Salzburg	Sankt Johann im Pongau	Eben im Pongau*
Steiermark	Hartberg-Fürstenfeld	Waldbach-Mönichwald*
Steiermark	Murtal	Pölstal*
Steiermark	**Weiz**	**Anger***
Niederösterreich	Melk	Texingtal*
Oberösterreich	Gmunden	Bad Goisern am Hallstättersee*
Tirol	Kitzbühel	Brixen im Thale*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 893, datë 3.9.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Austrisë", shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 917, datë 9.9.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE DHIVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E RUMANISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës së kafshëve të llojit dhen dhe dhi, nga i gjithë shteti i Rumanisë.

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen

dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës së kafshëve të llojit dhen dhe dhi.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës së kafshëve të llojit dhen dhe dhi, për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Urdhri nr. 913, datë 8.9.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive, të shfaqur në shtetin e Rumanisë", shfuqizohet.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

VENDIM
Nr. 251, datë 3.9.2026

MBI NJOHJEN DHE LEJIMIN E OPERIMIT TË IMPIANTIT TË DEPOZITIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË "GREENSOL" SHPK

Në mbështetje të neneve 16, 51 dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike"; të nenit 11, pika 3, të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"; të neneve 13, 14, pika 9 dhe 15, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; të "Rregullave për njoftimin dhe regjistrimin pranë ERE-s të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 230, datë 18.8.2026, si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.9.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1662/20 prot., datë 2.9.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi njohjen dhe lejimin e operimit të sistemeve të energjisë elektrike të shoqërisë 'GreenSol' sh.p.k.",

konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria "GreenSol" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1662 prot., datë 22.5.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, qarku Vlorë, me kapacitet të instaluar 49.96 mw, për të cilën Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 158, datë 5.6.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1662/5 prot., datë 19.6.2026, ajo ka paraqitur kërkesën për modifikimin e licencës, duke shtuar në të dhe elementet e depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar asnjë element tjetër teknik të aplikimit të saj.

- Për sa më sipër dhe në rrethanat kur shoqëria ishte në proces për marrjen e licencës, është vlerësuar se kemi të bëjmë me një përditësim të projektit të centralit fotovoltaik, ndaj, me vendimin nr. 179, datë 29.6.2026, Bordi i ERE-s vendosi të ndryshojë vendimin nr. 158/2026, duke pranuar për shqyrtim në këtë fazë përfshirjen e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë vetëm për fuqinë 49.96 mw.

- Për vendimin e sipërcituar, ERE botoi njoftimin në median e shkruar, në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s në datat 1.7.2026 dhe 2.7.2026. Në përfundim të afatit (data 30.7.2026) ka rezultuar se nuk ka pasur komente apo objeksione.

- Me shkresën nr. 1662/10 prot. datë 14.7.2026, ERE ka njoftuar Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për vendimin nr. 179/2026, ndërsa me

shkresën nr. 1662/11 prot., datë 14.7.2026, ERE ka njoftuar "OST" sh.a. për vendimin e sipërcituar.

- Rezulton se në protokollin e ERE-s është administruar shkresa e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me nr. 4755/1 prot., datë 29.6.2026, protokolluar në ERE me nr. 1291/9 prot., datë 1.7.2026, sipas të cilës ndryshimet e propozuara në projekt duhet të trajtohen në përputhje me të drejtën për ndërtim dhe kontratën e lidhur ndërmjet ministrisë dhe shoqërisë, si dhe duke qenë se ERE i është drejtuar shoqërisë (me shkresën nr.1662/9 prot., datë 14.7.2026), duke i kërkuar qëndrimin e MIE-s, në lidhje me shtimin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 197, datë 21.7.2026, vendosi të pezullojë procedurën deri në administrimin nga ERE të qëndrimit së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

- Ky vendim i është njoftuar shoqërisë nëpërmjet shkresës së ERE nr. 1662/15 prot., datë 29.7.2026, me anë të së cilës i është kërkuar dhe depozitimi i qëndrimit të MIE-s, në lidhje me shtimin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike.

- Rezulton se me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 212, datë 28.7.2026, "Mbi licencimin e shoqërisë 'GreenSol' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 49.96 mw", shoqëria "GreenSol" sh.p.k. është licencuar tashmë, për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik me kapacitet të instaluar 41.29 mw. Ky kapacitet është përcaktuar duke iu referuar fuqisë nominale të centralit në rrymë alternative (AC), për të cilën është lëshuar miratimi në parim nga "OST" sh.a. është vlerësuar projekti në kuadër të procedurës së VNM-së paraprake dhe për sa ka rezultuar nga analiza dhe përllogaritja e prodhimit vjetor të parashikuar në kontratën e nënshkruar me MIE-n, ku nga të gjitha këto dokumente rezulton se totali i kapacitetit të duhet të injektohet në rrjet është 41.29 mw.

- Në vijim, MIE, me shkresën nr. 4755/13 prot., datë 3.8.2026, protokolluar në ERE me nr. 1662/18 prot., datë 5.8.2026, ka sqaruar ndër të tjera, se, në zbatim të nenit 51, pikat 3, 4 dhe 5, të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike", impiantet në zhvillim ose operim në hyrjen në fuqi të ligjit, pa licencën përkatëse, njihen dhe lejohen të operojnë sipas licencës ekzistuese, në kushtet dhe afatet e përcaktuara nga ky nen. Në këtë kuadër, MIE vlerëson se shoqëria "GreenSol" sh.p.k. mund të vijojë operimin sipas licencës ekzistuese gjatë periudhës tranzitore të parashikuar nga ligji, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në ligj.

- Në kushtet kur sistemet e depozitimit të energjisë elektrike janë deklaruar nga shoqëria, në kuadër të procedurës së licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, si pjesë e projektit të centralit fotovoltaik dhe pa rritur kapacitetin e instaluar të tij, duke mbajtur në konsideratë regjimin kalimtar të parashikuar në nenin 51, të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe qëndrimin e MIE-s të administruar me shkresën nr. 4755/13 prot., datë 3.8.2026, vlerësohet se këto sisteme do të trajtohen në përputhje me këtë regjim. Njohja dhe lejimi i vijimit të operimit të tyre gjatë periudhës kalimtare nuk përbën dhënie të një licence të re për veprimtarinë e depozitimit dhe as modifikim të licencës së prodhimit apo ndryshim të kapacitetit të instaluar të centralit fotovoltaik.

- Me administrimin nga ERE të qëndrimit të MIE-s, vlerësohet se është përmbushur qëllimi dhe kushti mbi të cilin është bazuar pezullimi i procedurës, sipas pikës 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 197, datë 21.7.2026. Për rrjedhojë, kushti i përcaktuar në këtë pikë konsiderohet i ezauruar në kuadër të këtij pezullimi.

- Shoqëria ka detyrimin që gjatë të gjithë kohës së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë, injektimi i energjisë elektrike në rrjet të mos tejkalojë kapacitetin e instaluar të centralit fotovoltaik prej 41.29 mw.

- Në zbatim të regjimit kalimtar të parashikuar në nenin 51, të ligjit nr. 59/2026, shoqërisë i njihet e drejta e vijimit të operimit të sistemeve të depozitimit të deklaruara pranë ERE-s, deri në përfundimin e periudhës 12-mujore të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, brenda së cilës shoqëria ka detyrimin të aplikojë për licencimin e veprimtarisë së operimit të impiantit të depozitimit, sipas legjislacionit në fuqi.

- Duke qenë se me vendimin nr. 230, datë 18.8.2026, ERE ka miratuar "Rregullat për njoftimin dhe regjistrimin pranë ERE-s të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar", vlerësohet se informacioni dhe dokumentacioni i administruar në këtë procedurë

mund të përdoret edhe për qëllimet e njoftimit dhe regjistrimit, duke u plotësuar, kur është e nevojshme, me dokumentacionin shtesë të kërkuar. Përmbushja e këtyre kërkesave do të trajtohet në kuadër të procesit të njoftimit dhe regjistrimit.

- Pagesa kryer nga shoqëria, në kuadër të veprave ndihmëse, do të rakordohet në vijim me strukturën e financës, duke u marrë në konsideratë në raport me detyrimet financiare të pagesave të rregullimit që shoqëria do të ketë ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të njohë operimin e impiantit të depozitimit të energjisë elektrike të deklaruar nga shoqëria "GreenSol" sh.p.k., të përbërë nga 29 (njëzet e nëntë) njësi me kapacitet energjetik 6.9 mwh secila, me kapacitet total energjetik 200.01 mwh, dhe të lejojë vijimin e operimit të tij në kuadër të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 212, datë 28.7.2026.

2. Shoqëria "GreenSol" sh.p.k. ka detyrimin të sigurojë që, gjatë të gjithë kohës së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë, fuqia totale e injektuar në pikën e lidhjes në rrjet të mos tejkalojë në asnjë moment 41.29 mw, përkatësisht kapacitetin e instaluar të centralit fotovoltaik të licencuar, si dhe të respektojë kushtet dhe kufizimet teknike të përcaktuara nga operatori i rrjetit.

3. E drejta për vijimin e operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike sipas pikës 1 të këtij vendimi i njihet shoqërisë vetëm për periudhën kalimtare të parashikuar në nenin 51, të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike". Shoqëria ka detyrimin që, brenda afatit 12-mujor të përcaktuar në pikën 5, të nenit 51 të këtij ligji, të paraqesë pranë ERE-s aplikimin për licencimin e veprimtarisë së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike, në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi për ushtrimin e këtij aktiviteti.

4. Njohja dhe lejimi i operimit sipas këtij vendimi nuk përbën dhënie apo modifikim të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe nuk ndryshon kapacitetin e instaluar prej 41.29 mw, të përcaktuar në licencën e shoqërisë "GreenSol" sh.p.k.

5. Përfundimi i periudhës kalimtare të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi nuk krijon të drejtë për vijimin e operimit të sistemeve të depozitimit të energjisë elektrike, në kuadër të licencës së prodhimit, përtej rasteve dhe kushteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

6. Ky vendim është objekt rishikimi në rast se rezulton se të dhënat, dokumentacioni ose rrethanat mbi të cilat është bazuar vendimmarrja e Bordit të ERE-s kanë ndryshuar ose nuk përputhen me gjendjen faktike dhe juridike të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike.

7. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "GreenSol" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe shoqërinë "Operatori i Sistemit të Transmetimit" (OST) sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 252, datë 3.9.2026

MBI NJOHJEN DHE LEJIMIN E OPERIMIT TË IMPIANTIT TË DEPOZITIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË "GERTI" SHPK

Në mbështetje të neneve 16, 51 dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike"; të nenit 11, pika 3, të ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e

rinovueshme"; të neneve 13, 14, pika 9 dhe 15, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; të "Rregullave për njoftimin dhe regjistrimin pranë ERE-s të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 230, datë 18.8.2026, si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.9.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2015/22 prot., datë 2.9.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi njohjen dhe lejimin e operimit të sistemeve të energjisë elektrike të shoqërisë 'Gerti' sh.p.k.",

konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria "Gerti" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2015 prot., datë 2.7.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 10 mw, me vendndodhje në Vlashaj, Njësia Administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër, duke përfshirë dhe veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit.

- Në vijim të këtij aplikimi, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 193, datë 13.7.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari, ku me shkresën nr. 2015/6 prot., datë 17.7.2026, ERE ka njoftuar Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. për fillimin e kësaj procedure. Nga ana e tyre nuk ka rezultuar të jetë depozituar ndonjë përgjigje.

- ERE, po ashtu, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 2015/7 prot., datë 17.7.2026, ku ndër të tjera është referuar dhe kërkesa e shoqërisë për përfshirjen e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike dhe se ERE i ka kërkuar shoqërisë që të depozitojë qëndrimin përkatës të MIE-s për sa kërkuar nga shoqëria, në lidhje me këto njësi depozitimi.

- Për këtë kërkesë të shoqërisë dhe për trajtimin e rasteve të ngjashme, MIE është njoftuar dhe me shkresën e ERE-s nr. 2234 prot., datë 27.7.2026, ku është kërkuar një qëndrim institucional, duke qenë se trajtimi i veprave të depozitimit të energjisë elektrike kërkon një vlerësim të harmonizuar ndërmjet dispozitave të ligjit nr. 59/2026, kushteve kontraktuale dhe akteve administrative që kanë mundësuar zhvillimin e projektit.

- Rezulton se aktualisht shoqëria është pajisur me licencën përkatëse për prodhimin e energjisë elektrike, nëpërmjet vendimit të Bordit nr. 223, datë 10.8.2026, ku në konstatimet e këtij vendimi është vlerësuar se kërkesa e shoqërisë për përfshirjen në licencë të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike do të bëhet në vijim, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe me procedurën përkatëse të përcaktuar nga ERE.

- Në vijim, në ERE është depozituar shkresa e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 6448/1 prot., datë 27.8.2026, protokolluar në ERE me nr. 2234/1 prot., datë 28.8.2026, ku ka sqaruar, ndër të tjera se, në zbatim të nenit 51, pikat 3, 4 dhe 5, të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike", impiantet në zhvillim ose operim në hyrjen në fuqi të ligjit, pa licencën përkatëse, njihen dhe lejohen të operojnë sipas licencës ekzistuese, në kushtet dhe afatet e përcaktuara nga ky nen. Në këtë kuadër, MIE vlerëson se shoqëria "Gerti" sh.p.k. mund të vijojë operimin sipas licencës ekzistuese gjatë periudhës tranzitore të parashikuar nga ligji, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në ligj.

- Në kushtet kur sistemet e depozitimit të energjisë elektrike janë deklaruar nga shoqëria, në kuadër të procedurës së licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, si pjesë e projektit të centralit fotovoltaik dhe pa rritur kapacitetin e instaluar të tij, duke mbajtur në konsideratë regjimin kalimtar të parashikuar në nenin 51, të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe qëndrimin e MIE-s të përcjellë me shkresën nr. 6448/1 prot., datë 27.8.2026, vlerësohet se këto sisteme do të trajtohen në përputhje me këtë regjim.

- Për rrjedhojë, vlerësohet se ekzistojnë kushtet për përfundimin e trajtimit të kërkesës së shoqërisë, nëpërmjet njohjes së sistemeve të depozitimit të energjisë elektrike të shoqërisë "Gerti" sh.p.k., të përbëra nga 2 (dy) njësi me kapacitet energjetik 5

mwh secila, me kapacitet total energjetik 10 mwh, dhe lejimit të vijimit të operimit të tyre gjatë regjimit kalimtar të parashikuar nga neni 51, i ligjit nr. 59/2026. Ky trajtim nuk përbën dhënie të një licence të re për veprimtarinë e depozitimit dhe as modifikim të licencës së prodhimit të energjisë elektrike apo ndryshim të kapacitetit të instaluar të centralit fotovoltaik prej 10 mw. Shoqëria ka detyrimin që gjatë të gjithë kohës së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë, injektimi i energjisë elektrike në rrjet të mos tejkalojë kapacitetin e instaluar të centralit fotovoltaik prej 10 mw.

- Në zbatim të regjimit kalimtar të parashikuar në nenin 51, të ligjit nr. 59/2026, shoqërisë i njihet e drejta e vijimit të operimit të sistemeve të depozitimit të deklaruara pranë ERE-s, deri në përfundimin e periudhës 12-mujore të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, brenda së cilës shoqëria ka detyrimin të aplikojë për licencimin e veprimtarisë së operimit të impiantit të depozitimit, sipas legjislacionit në fuqi.

- Duke qenë se me vendimin nr. 230, datë 18.8.2026, ERE ka miratuar "Rregullat për njoftimin dhe regjistrimin pranë ERE-s të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar", vlerësohet se informacioni dhe dokumentacioni i administruar në këtë procedurë mund të përdoret edhe për qëllimet e njoftimit dhe regjistrimit, duke u plotësuar, kur është e nevojshme, me dokumentacionin shtesë të kërkuar. Përmbushja e këtyre kërkesave do të trajtohet në kuadër të procesit të njoftimit dhe regjistrimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të njohë operimin e sistemit të depozitimit energjisë elektrike të deklaruar nga shoqëria "Gerti" sh.p.k., të përbërë nga 2 (dy) njësi me kapacitet energjetik 5 mwh secila, me kapacitet total energjetik 10 mwh, dhe të lejojë vijimin e operimit të tij, në kuadër të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 223, datë 10.8.2026.

2. Shoqëria "Gerti" sh.p.k. ka detyrimin të sigurojë që gjatë të gjithë kohës së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë fuqia totale e injektuar në pikën e lidhjes në rrjet të mos tejkalojë në asnjë moment 10 mw, përkatësisht kapacitetin e instaluar të centralit fotovoltaik të licencuar, si dhe të respektojë kushtet dhe kufizimet teknike të përcaktuara nga operatori i rrjetit.

3. E drejta për vijimin e operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike, sipas pikës 1, të këtij vendimi, i njihet shoqërisë vetëm për periudhën kalimtare të parashikuar në nenin 51, të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike". Shoqëria ka detyrimin që, brenda afatit 12-mujor të përcaktuar në pikën 5, të nenit 51 të këtij ligji, të paraqesë pranë ERE-s aplikimin për licencimin e veprimtarisë së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike, në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi për ushtrimin e këtij aktiviteti.

4. Njohja dhe lejimi i operimit sipas këtij vendimi nuk përbën dhënie apo modifikim të licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe nuk ndryshon kapacitetin e instaluar prej 10 mw, të përcaktuar në licencën e shoqërisë "GERTI" sh.p.k".

5. Përfundimi i periudhës kalimtare të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi nuk krijon të drejtë për vijimin e operimit të sistemeve të depozitimit të energjisë elektrike, në kuadër të licencës së prodhimit, përtej rasteve dhe kushteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

6. Ky vendim është objekt rishikimi në rast se rezulton se të dhënat, dokumentacioni ose rrethanat mbi të cilat është bazuar vendimmarrja e Bordit të ERE-s kanë ndryshuar ose nuk përputhen me gjendjen faktike dhe juridike të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike.

7. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "Gerti" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe shoqërinë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" (OSSH) sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në

Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 253, datë 3.9.2026

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 68, DATË 8.4.2025, "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË 'RENEW' SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 16 dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike"; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.9.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 817/7 prot., datë 1.9.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 68, datë 8.4.2025, 'Mbi licencimin e shoqërisë 'Renew' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw', i ndryshuar",

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë "Renew" sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 68, datë 8.4.2025, i ndryshuar me vendimin 162, datë 5.6.2026, ka vendosur të licencojë shoqërinë "Renew" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

- Në pikën 4 të këtij vendimi përcaktohet se "Brenda datës 16.8.2026, shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacion të përditësuar mbi stafin teknik". Ndërsa në pikën 5 përcaktohet se ky vendim është objekt rishikimi në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve në pikën 4.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Në kuadër të zbatimit të kushteve të vendimit të sipërcituar, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 817/6, datë 5.8.2026, shoqëria ka përcjellë "Marrëveshjen e përfundimit të kontratës së shërbimit me shoqërinë 'Construction Energy Parts' sh.p.k.", mbi përfundimin e ofrimit të shërbimit më datë 31.7.2026 dhe "Kontratën e shërbimit të operimit dhe mirëmbajtjes me shoqërinë 'Kirac Green Energy' sh.p.k.", datë 1.8.2026, me afat 2-vjeçar (dyvjeçar)vjeçar, së bashku dokumentacionin e kualifikimit teknik të personelit të angazhuar për ofrimin e shërbimit nga shoqëria "Kirac Green Energy" sh.p.k..

- Duke marrë në konsideratë përmbushjen e kushtit të përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 162/2026, shoqëria kërkon që ERE të reflektojë përmbushjen e tij dhe të procedohet me shfuqizimin në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar rezulton se shoqëria ka përmbushur brenda afatit detyrimin e përcaktuar në pikën 4, të vendimit nr. 68, datë 8.4.2025, të ndryshuar, duke paraqitur informacionin/dokumentacionin e përditësuar mbi stafin teknik të angazhuar për operimin dhe mirëmbajtjen e centralit fotovoltaik.

- Sa i përket kërkesës së shoqërisë për shfuqizimin e detyrimit të përcaktuar në pikën 4 të vendimit, vlerësohet se, ndonëse detyrimi për depozitimin e informacionit brenda datës 16.8.2026 është përmbushur, sigurimi i kapaciteteve të nevojshme teknike përbën një kërkesë që duhet të përmbushet përgjatë gjithë kohës se ushtrimit të veprimtarisë së licencuar dhe kontrata e shërbimit e paraqitur nga shoqëria ka afat deri më 1.8.2028, vlerësohet që në përfundim të këtij afati shoqëria të depozitojë pranë ERE-s informacion të përditësuar mbi stafin teknik të angazhuar për ushtrimin e veprimtarisë së licencuar.

- Ndryshimi i pikës 4, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 68, datë 8.4.2025, të ndryshuar, nuk

cenon zbatimin e pikës 5 të këtij vendimi, e cila mbetet në fuqi dhe do të zbatohet në lidhje me detyrimin e përcaktuar në pikën 4, sipas përmbajtjes dhe afatit të ri të përcaktuar me këtë vendim.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 68, datë 8.4.2025, i ndryshuar, si vijon:

a) Pika 4 ndryshon dhe bëhet:

"4. Brenda datës 1.8.2028, shoqëria "Renew" sh.p.k. të depozitojë pranë ERE-s informacion të përditësuar mbi stafin teknik të angazhuar për ushtrimin e veprimtarisë së licencuar.".

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "Renew" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), shoqërinë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" (OSSH) sh.a., shoqërinë "Furnizuesi i Tregut të Lirë" (FTL) sh.a. dhe shoqërinë "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike" (ALPEX) sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 254, datë 3.9.2026

MBI PEZULLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË "KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (SHA KESH)" SHA NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA TEC-et LUNDRUESE "TIGRI 1", ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 mw, DHE "TIGRI 3", ME KAPACITET TË INSTALUAR 60 mw

Në mbështetje të nenit 16 dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike"; të nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; të nenit 14, pika 10, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.9.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1950/29 prot., datë 2.9.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (sh.a. KESH)' sh.a. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-et lundruese "Tigri 1", me kapacitet të instaluar 50 mw, dhe "Tigri 3", me kapacitet të instaluar 60 mw",

konstatoi se:

- Shoqëria "Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH)" sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1950 prot., datë 23.6.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-et lundruese "Tigri 1", me kapacitet të instaluar 50 mw dhe "Tigri 3", me kapacitet të instaluar 60 mw, me vendndodhje në Portin e Triportit, në Gjirin e Vlorës.

- Me vendimin nr. 185, datë 6.7.2026, Bordi i ERE-s ka vendosur fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë.

- ERE botoi njoftimin për fillimin e kësaj procedure në median e shkruar në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, në datat 7.7.2026 dhe 8.7.2026. Brenda afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data e fundit 5.8.2026) ka rezultuar se ka pasur të tilla, të cilat i janë dërguar KESH sh.a. dhe nga ana e shoqërisë janë depozituar parashtrime. Objeksionet e paraqitur dhe parashtrimet e shoqërisë mbi këto objeksionet janë në proces shqyrtimi.

- Në kuadër të shqyrtimit të aplikimit, ERE ka zhvilluar korrespondencën përkatëse me shoqërinë për plotësimin e informacionit/dokumentacionit të aplikimit, si dhe me institucionet kompetente, ndër të tjera me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) (shkresa nr. 1950/3 prot., datë 14.7.2026), Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) (shkresa nr. nr. 1950/7 prot., datë 14.7.2026), Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. (shkresa nr. 1950/5 prot. datë 14.7.2026) dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) (shkresa nr. 1950/6 prot. datë 14.7.2026), me qëllim verifikimin e përmbushjes së kërkesave ligjore dhe rregullatore për ushtrimin e veprimtarisë së kërkuar.

- MIE me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1950/16 prot., datë 5.8.2026, ka shprehur qëndrimin e saj, duke përcaktuar se "Referuar parashikimeve të kontratës së qirasë, operimit dhe mirëmbajtjes 'Bareboat'" dhe Marrëveshje për Shërbimet O& me, me nr. 1660 prot., datë 4.4.2022, amenduar me kontratën nr. 1660/7 prot., datë 7.4.2022, me përfundimin e afatit të qirasë, asetet termike kalojnë në pronësi të KESH sh.a, në përputhje me nenet 15 dhe 16 të kontratës. Në këto kushte, e ndryshimi i natyrës juridike të asetit është parashikuar shprehimisht në kontratë, në përputhje me kushtet e saj për kalimin e pronësisë dhe si i tillë nuk përbën dhënien e një të drejtë për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese dhe të depozitimit të energjisë, të cilat nuk janë objekt koncesioni sipas përcaktimeve të nenit 52, të ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike".

- OST sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1950/12 prot., datë 3.8.2026, ka bërë me dije se, për shkak të ndryshimit të statusit juridik të aseteve, KESH sh.a. duhet t'i drejtohet OST sh.a. për amendimin e Marrëveshjes së Lidhjes me Rrjetin e Transmetimit. Në vijim, KESH sh.a. ka depozituar kërkesën e drejtuar OST sh.a. për amendimin e Marrëveshjes së Lidhjes. Nuk rezulton të jetë depozituar pranë ERE-s dokumenti i amenduar/miratuar, por shoqëria ka bërë aplikimin e saj, e si e tillë ka detyrën për depozitimin e këtij dokumenti në ERE.

- Nga ana e AMBU-së nuk rezulton të jetë depozituar ndonjë qëndrim vijues, por rezulton se shoqëria ka një leje të vlefshme për përdorimin e burimit ujor deri në datën 15.3.2028.

- AKM me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1950/15 prot., datë 5.8.2026, ka informuar se KESH sh.a. disponon leje mjedisi me Kod III.1.C, me PN-1673-03-2023, duke referuar gjithashtu se shoqëria ka aplikuar për pajisjen me leje mjedisi me kod LC-8477-0102023 dhe duke depozituar dokumentacionin e aplikimit bashkëlidhur për vlerësimin e ERE-s.

- Duke qenë se informacioni i përcjellë me shkresën nr. 1950/15 prot., datë 5.8.2026, nuk adresonte në mënyrë të plotë çështjen e vlefshmërisë së lejes/lejeve mjedisore për operimin e TEC-eve dhe po ashtu, duke qenë se vlerësimi i dokumentacionit mjedisor, përcaktimi i lejeve mjedisore të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë, si dhe vlerësimi i vlefshmërisë dhe mjaftueshmërisë së tyre për operimin e instalimit përkatës nuk bëjnë pjesë në kompetencat ligjore të ERE-s, me shkresën nr. 1950/20 prot., datë 12.8.2026, ERE i ka kërkuar AKM-së të informojë nëse KESH sh.a. disponon të gjitha lejet e nevojshme mjedisore për operimin e TEC-eve lundruese "Tigri 1" dhe "Tigri 3".

- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1950/26 prot., datë 27.8.2026, AKM ka informuar sërish se, nga verifikimi në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave, rezulton se KESH sh.a. disponon leje mjedisi me kod III.1.C, me PN-1673-03-2023, për të cilën ka depozituar pranë ERE-s edhe kopjen e lejes mjedisore, si dhe dokumentin me emërtimin "Leje", me PN-1673-03-2023, ku pjesa takuese për afatin e vlefshmërisë nuk ka një përcaktim apo afat (është e paplotësuar).

- Për sa më lart, duke qenë se në pikën 1.5.2 përcaktohet se kjo leje është dhënë në bazë të kontratës së qirasë dhe në faqen 62 përcaktohet se: Kjo leje është e vlefshme vetëm për periudhën e vlefshmërisë së kontratës së qirasë për mjetet lundruese të prodhimit të energjisë elektrike dhe në kushtet kur, vetë KESH sh.a. ka njoftuar AKM-në, se pas përfundimit të afatit të qirasë, statusi juridik i

asetit do të ndryshojë dhe ai do të vijojë të trajtohet dhe administrohet si aset i KESH sh.a., ERE i është drejtuar AKM-së me shkresën nr. 1950/28 prot., datë 1.9.2026, ku në referencë të gjithë sa më sipër, i është kërkuar qëndrim konkret nëse leja aktuale është e vlefshme apo shoqëria duhet të pajiset me leje apo akte të tjera mjedisore të nevojshme sipas legjislacionit në fuqi për operimin e TEC-eve lundruese "Tigri 1" dhe "Tigri 3".

- Për gjithë sa më sipër parashtruar, referuar parashikimeve të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi, vlerësohet se marrja e qëndrimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), lidhur me vlefshmërinë dhe efektet juridike të lejes/lejeve mjedisore të nevojshme për operimin e TEC-eve Lundruese "Tigri 1" dhe "Tigri 3", është një çështje që lidhet drejtpërdrejt me verifikimin e mundësisë juridike dhe faktike të ushtrimit të veprimtarisë për të cilën kërkohet licencimi. Në këtë kuptim, vlerësohet se kjo përbën një çështje paraprake në kuptim të nenit 66 të Kodit të Procedurave Administrative, pasi zgjidhja e saj është parakusht për marrjen e një vendimi përfundimtar mbi procedurën e licencimit, ndërkohë që ajo ka karakter të pavarur nga kjo procedurë dhe zgjidhja e saj i përket kompetencës së organeve/subjekteve përkatëse, dhe jo ERE-s.

Argumentimi ligjor

- Në nenin 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, "Kodit i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", parashikohet se nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (çështja paraprake), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.

- Po ashtu, në nenin 14, pika 10 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, parashikohet se Bordi i ERE-s, rast pas rasti, pas fillimit të procedurës, mund të vendosë të pezullojë vendimmarrjen e tij.

- Në këto kushte, vlerësohet e nevojshme pezullimi i afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë "KESH" sha për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-et Lundruese "Tigri 1", me kapacitet të instaluar 50 mw, dhe "Tigri 3", me kapacitet të instaluar 60 mw, me vendndodhje në Portin e Triportit, në Gjirin e Vlorës, deri në depozitimin pranë ERE-s të qëndrimit përkatës të AKM-së mbi vlefshmërinë e lejes mjedisore të shoqërisë "KESH" sh.a. apo nëse shoqëria duhet të pajiset me leje apo akte të tjera mjedisore të nevojshme sipas legjislacionit në fuqi për operimin e TEC-eve lundruese.

- Me administrimin e këtij qëndrimi do të konsiderohet e ezauruar arsyeja që ka sjellë pezullimin e procedurës dhe për rrjedhojë, procedura administrative rifillon dhe vijon shqyrtimi i kërkesës së shoqërisë "KESH" sh.a., në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë procedurën administrative të licencimit të shoqërisë "Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (sh.a KESH)" sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga TEC-et Lundruese "Tigri 1", me kapacitet të instaluar 50 mw, dhe "Tigri 3", me kapacitet të instaluar 60 mw, me vendndodhje në Portin e Triportit, në Gjirin e Vlorës.

2. Pezullimi do të zgjasë deri në administrimin nga ERE të qëndrimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për vlefshmërinë e lejes/lejeve mjedisore të shoqërisë "KESH" sh.a për operimin e TEC-eve lundruese "Tigri 1" dhe "Tigri 3".

3. Me administrimin nga ERE të qëndrimit të AKM-së që adreson çështjet e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, konsiderohet e ezauruar arsyeja e pezullimit dhe procedura administrative rifillon, duke vijuar shqyrtimi i kërkesës së shoqërisë "KESH" sh.a. për licencim.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë "Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (sh.a. KESH)" sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), shoqërinë "Operatori Sistemit Transmetimit" (OST) sh.a. dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), si dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË
Nr. 1030/5, datë 11.9.2026

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 657, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave 'Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qukës–Pogradec – Qafë Plloçë'", i ndryshuar, me vlerë totale paraprake të shpronësimit prej 142,464 (njëqind e dyzet e dy mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër) lekësh.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

- Për pasurinë e llojit "arë" është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë";

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Autoriteti Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 142,464 (njëqind e dyzet e dy mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT, "PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 657, DATË 8.10.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, 'PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR QUKËS – POGRADEC – QAFË PLLOÇË'", I NDRYSHUAR

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Të dhënat e pasurisë				Tokë "arë"			Vlera totale (lekë)	Adresa e pronarit
				Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale m²	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera lekë		
1	Bexhet	Xhemal	Kapri	1795	42/11	Arë	2370	742	192.00	142,464.00	142,464.00	Durrës, Rruga Bajram Alite 00690101 Ndërtesa nr. 51 SH/K 1.
	SHUMA TOTALE										142,464.00	

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 304 lekë

||FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË|Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare|Viti: 2026 - Numri: 199|Datë: 15.09.2026 14:35:16 +02:00|98440a43-8a75-4629-a5db-e6a8646602bc

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë|të një procedure automatike nga një sistem elektronik|(Qendra e Botimeve Zyrtare)